

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Seanca gjyqësore - Vazhdon gjykimi për sulmin në kanalën
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/919839/vazhdon-gjykimi-per-sulmin-ne-kanalin-iber-lepenc/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 07:09:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 06:43:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8feca991ae9ca7e08257589e06087587df5d825ef5a8d241f53c68d2cc456134
TEKSTI	9c3898fb8789e8c484360d4e626cf25bd92a2463d0846cb7b859783c1f5a9bdf
PAMJA	31ffef4c4da9ab4c4560664bee7bb1a882722b2332390a7276aa0e71dc14e0ca

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	70b851ee0bf1dd91befe2625c3d756c07a5cceeef6610a776d833d2600543d65
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c6f9264c70fd67f9aaea8ca8a31d0350f363dc326e3547de2dbe3cea0108618b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/70b851ee0bf1dd91befe2625c3d756c07a5cceeef6610a776d833d2600543d65>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Vazhdon gjykimi për sulmin në kanal in 'Ibër-Lepenc'

08:43, 29/09/2026

Në Pallatin e Drejtësisë në Prishtinë, sot në orën 09:30, mbahet seanca gjyqësore ndaj tre të pandehurve për sulmin në kanal in "Ibër-Lepenc", i cili ndodhi më 29 nëntor 2024 në fshatin Varagë të Zubin-Potokut.

Prokuroria Speciale e Kosovës i akuzon të tre të pandehurit për armëmbajtje pa leje, ndërsa vëllezërit Jovan dhe Dragisha Viqentijeviq akuzohen edhe për veprat penale të rrezikimit të rendit kushtetues me shkatërrimin ose dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike, kryerjes së veprës terroriste dhe spiunazhit.

Aktakuza ndaj tre të pandehurve është ngritur më 9 dhjetor 2025 nga Prokuroria Speciale, e cila i lidh të akuzuarit me sulmin që shkaktoi dëme të konsiderueshme në kanal in "Ibër-Lepenc", një prej objekteve kryesore të infrastrukturës ujore të Kosovës.

Në aktakuzën e ngritur nga prokurori Bekim Kodraliu janë përfshirë edhe deklaratimet e Jovan Viqentijeviqit para Prokurorisë. Sipas aktakuzës, ai ka deklaruar se ishte trajnuar në poligonin e ushtrisë serbe "Pasulanske Livade", së bashku me rreth 120 persona të tjerë, gjatë periudhës 14–23 shtator 2023.

Sipas Prokurorisë, në të njëjtin poligon, gjatë shtatorit 2023, ishin zhvilluar trajnime edhe nga grupi i Milan Radoičiqit, i cili akuzohet se ishte përfshirë në sulmin e armatosur në Banjskë të Zvečanit më 24 shtator 2023.

Në deklarinimin e tij, sipas aktakuzës, Viqentijeviq ka thënë se në Kosovë ishte planifikuar edhe një sulm tjetër në tetor 2024, por se ky plan ishte anuluar. Në aktakuzë përmendet gjithashtu deklarimi se për realizimin e këtij sulmi ishte pritur përfundimi i zgjedhjeve presidenciale në Shtetet e Bashkuara.

Në mesin e provave të administruara nga Prokuroria është edhe një ekspertizë e kryer nga Byroja Federale e Hetimit (FBI). Sipas aktakuzës, ekspertiza ka konstatuar se materiali i gjetur në çizmet e të akuzuarve kishte strukturë, ngjyrë dhe përbërje të njëjtë me mostrën e marrë në vendin e shpërthimit në kanal in "Ibër-Lepenc".

Sulmi në kanal in "Ibër-Lepenc" ndodhi më 29 nëntor 2024 në Varagë të Zubin-Potokut, ku një shpërthim dëmtoi rëndë kanal in që furnizon me ujë pjesë të rëndësishme të Kosovës dhe luan rol në proceset e prodhimit të energjisë.

Në seancat gjyqësore pritet të shqyrtohen provat e Prokurorisë dhe të mbrojtjes,

më të lexuarat

Identifikohen mbetje mortore të dy personave, nuk janë nga 'Grupi i Intelektualëve'

Kurti takohet me Hamzën, një ditë para seancës së Kuvendit

FOTO/ E rrallë, Bardhosh Gërvalla në demonstratën e vitit 1981 në Zvicër

12 netë protesta kundër dënimit të ish-udhëheqësve të UÇK-së

Prishtina edhe sonte në protestë, qytetarët mblidhen në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

Vazhdon gjykimi për sulmin në kanal in 'Ibër-Lepenc'

Digjet sërish shtëpia e gazetarit Vudi Xhymshiti, ai ngre dyshime për lidhje me punën e tij, përmend figura të PDK dhe AAK

si dhe deshimte ngritur me nevojat e shprehura dhe tërësi të pretenduar të të akuzuarve.

Të pandehurit konsiderohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të vërtetohet me aktgjykim të formës së prerë./ RTK.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Protesta e 13-të/ Qytetarë kundër dënimit të ish-udhëheqësve të UÇK-së



FOTO/ E rrallë, Bardhosh Gërvalla në demonstratën e vitit 1981 në Zvicër



Identifikohen mbetje mortore të dy personave, nuk janë nga 'Grupi i Intelektualëve'

Komentet

Shto koment

Posto

Gërvalla: Çështja e Speciales është betejë ligjore, jo betejë deklaratash

Kuvendi pritet të miratojë deklaratën për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara

TË NGJASHME



Kosovë/ Partitë ende pa marrëveshje për presidentin e ri



Kuvendi e quan të papranueshëm konstatimin e Speciales për 'qëllimin e përbashkët kriminal' nga katërshja e UÇK-së



I dogjën shtëpinë e prindërve, gazetari në Kosovë Vudi Xhymshiti poston pamjet: Nuk ndalem...



Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën lidhur me aktgjykimin e Speciales



PDK kushtëzon zgjedhjen e presidentit me votimin e projektligjit për Gjykatën Speciale



'Mesazh për Spallettin'/ Italianët mahnitën nga forma e Zhegrovës pas golit me Kosovën

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net